



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0829

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “TSR” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me numër të prokurimit 613-25-5988-2-1-1, me 20/10/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “TSR” SH.P.K. me nr. 2025/0829, e datës 29/08/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me numër të prokurimit 613-25-5988-2-1-1.

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me numër të prokurimit 613-25-5988-2-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.07.2025, “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613-25-5988-2-1-1. Ndërsa me datën 13.08.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie. OE “Sinjali SH.P.K.”- Ferizaj

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 170,000 €.

Me 19.08.2025, OE “TSR” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. E cila me vendimin e AK me datën 20.08.2025 është refuzuar si te pa bazuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me 29/08/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “TSR” SH.P.K., me nr. 2025/0829 për lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613-25-5988-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TSR” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Me datë 13.08.2025 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin përmes të cilit OE “Sinjal” Sh.P.K. e ka rekomanduar për kontratë ndërsa OE “Traffiks VA Sh.P.K.” e ka shpallur si të pasuksesshëm. Në rastin konkret të dy këta OE nuk kanë arritur që të përmbushin kërkesat e DT. Prandaj në vendimin e AK është dashur që të dy të eliminohen si të papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë OE “Sinjal” Sh.P.K. përkatësisht të shpallet si i pasuksesshëm OE “Traffiks VA Sh.P.K.”.

Pretendimi nr. 1 – OE “Sinjal” Sh.P.K. ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta. Fillimisht është e pakuptimtë se si ky OE ka ofertuar me çmime nga 10 cent (0.10 euro) si dhe nga 1 euro në paramasë dhe nga 5 euro. Tash e sa vite që punojmë në këtë treg ku aktualisht jemi edhe një nga OE lider në vend, asnjëherë nuk kemi parë por as nuk kemi dëgjuar që të vendoset sinjalizimi rrugor me çmime prej 10 cent dhe/apo 1 euro dhe apo 5 euro. Pra këto çmime jo vetëm që janë jonormalisht të ulëta, por janë absolutisht të palogjikshme, pakuptimta dhe mbi të gjitha janë të pasakta/pavërteta.

Sidoqoftë, ky OE ka ofertuar me 10 cent te pjesa 1 në poz. 3, 4 dhe 6, ndërsa pjesa 2 në poz. 3, 5, 6 dhe 12. Ndërsa me 1 euro ka ofertuar te pjesa 1 në poz. 7, 9, 10, 11, 12, 13, ndërsa te pjesa 2 në poz. 9, 10 dhe 11 ndërsa te pjesa 3 në poz. 4, 5, 7 dhe 17. Me 5 euro ka ofertuar te pjesa 3 në poz. 2, 3, 10, 14 dhe 15.

Të gjitha këto pozicione (të prezantuara edhe në vijim) janë jonormalisht të ulëta.

PERSHKRIMI I POZICIONEVE PJESA 2 PERSHKRIMI I POZICIONEVE PJESA 3

Çmimet jonormalisht të ulëta nga gjithsej 42 pozicione ky OE ka ofruar 25 pozicione me çmime jonormalisht të ulëta. Në shumicën e rasteve as me çmimin e mbeturinave të materialit nuk përputhen e aq më pak me çmimin e tregut të materialit. AK duke parë këto çmime është dashur të kërkoj nga OE sqarime shtesë me dëshmi të importit të këtyre produkteve pasi që siç dihet të gjitha këto produkte importohen (duhet të kemi prezantohet DUD-i doganor). Produktet që importohen janë plastika e ftohtë, plastika e ngrohtë apo termoplastika, ngjyra akrilike, perlet dhe këto produkte dihet çmimi importues andaj lind pyetja se ku është bazuar ky OE dhe është e mundur që AK nuk ka kërkuar të paktën sqarime shtesë për këto çmime jonormalisht të ulëta.

Çmimet jonormalisht të ulëta të cilat vërehen edhe më shumë dhe në mënyrë më të theksuar janë edhe ato të sinjalizimit vertikal ku ky OE një metër katror hekur me adeziv e ofron me

1 euro i cili as me çmimin e mbeturinave të hekurit nuk përputhet kur dihet se një metër katror hekur peshon 4 deri në 4.5 kg ndërsa çmimi i mbeturinave të hekurit sillet rreth 0.70euro.

Çmimi minimal i materialit në treg për sinjalizimin horizontal me masë plastike:

1. Plastikë e ftohtë 2K – 1 kg ka çmim blerjeje prej 1.88 €. Trashësia e kërkuar është 3 mm, dhe për mbulimin e 1 m² nevojiten 6 kg, që rezulton në një çmim për m² prej 11.28 € vetëm për materialin. Ky operator ekonomik (OE) ofron çmimin 4.00 € për m² në pozicionin 3, çmim që dukshëm nuk përputhet me realitetin e tregut.

2. Plastikë e nxehtë – Termoplastikë – Edhe për këtë material nevojiten 6 kg për m², ndërsa çmimi i blerjes në treg pa transport për një kg është 0.89 €, që i bie 5.34 € për m² vetëm për materialin, pa përfshirë kostot tjera. Këtyre çmimeve u shtohen edhe kostot e transportit, TVSH-ja, kostoja e punës dhe shpenzimet shtesë, bëhet fare e qartë se çmimi i ofruar nga ky OE është jo real dhe qesharak.

Ju, si Autoritet Kontraktues (AK), do të mund ta verifikoni lehtësisht këtë fakt nëse do të kërkonit çmimet e eksportit të këtyre produkteve. Do të bindeshit se çmimet e ofruara nuk mbulojnë as koston bazë, e lëre më të jenë çmime ekzekutimi apo fitimi, që është qëllimi i çdo OE-je

Kjo ngrit dyshime serioze, se ky OE ka pasur informacion paraprak për cilat pozicione do të ekzekutoheshin dhe cilat jo. Dyshimet shtohen edhe më shumë kur shohim dallimet e mëdha në çmimet e ofruara për produkte të njëjta dhe për të njëjtin sistem pune: Pozicioni 1 – 39.96 €/m² Pozicioni 3 – 4.00 €/m² Pozicioni 8 – 35.00 €/m² Pozicioni 7 – 1.50 €/m² Të gjitha këto për të njëjtin material, gjë që është kontradiktore dhe tregon për parregullsi. Gjithashtu, OE ka ofruar çmime anormalisht të ulëta edhe për fletët reflektuese të sinjalistikës vertikale, ku kërkesa ka qenë për produkte të klasit minimal I EGP (p.sh. 3M ose të ngjashme).

Lind pyetja: Si është e mundur që AK e pranon dhe e shpall si të përgjegjshëm një OE që ofron sinjalistikë rrugore me të gjitha aksesoret (hekuri apo alumini, adezivi, folia, lidhësit dhe montimi) me një çmim prej vetëm 1.5 €/m²?

Për të vërtetuar që ky çmim është joreal dhe qesharak, AK mund të kishte hulumtuar çmimet e tregut, ose t'i kërkonte OE-së të prezantojë dokumentacionin doganor të importit të këtyre materialeve. Çmimi minimal i blerjes për një produkt të tillë është nga 15 deri në 30 €, varësisht nga materiali dhe adezivi, sidomos kur bëhet fjalë për produkte që përmbajnë adezivë 3M.

Çmimi me të ka ofertuar ky OE është 89.77. Oferta e dytë më e lirë është 124.32 dhe si e tillë është dukshëm më e shtrenjtë sesa 10% sesa oferta e tenderuesit të rekomanduar. Tutje, në këtë aktivitet janë dorëzuar 5 oferta prej të cilave 4 janë cilësuar nga AK si të përgjegjshme. Mesatarja e çmimit të 4 ofertave të përgjegjshme është rreth 126.50 që nënkupton se oferta e tenderuesit të rekomanduar është rreth 30% më e lirë sesa mesatarja e çmimeve nga ofertat e përgjegjshme.

Përmes nenit 41.3 dhe 41.4. të RRPP është përcaktuar si vijon: Ndërsa përmes nenit 41.5 të RRPP përcaktohet si vijon: “Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët”.

Në rastin konkret AK nuk ka kërkuar fare sqarime për shkak të çmimit jo normalisht të ulët, përkundrazi këtë OE e ka rekomanduar për kontratë.

Pretendimi nr. 2 – OE “Sinjal” Sh.P.K. nuk e ka dorëzuar dëshmi dokumentare për makinën për gërryerjen e ngjyrës në asfalt. Në fakt ky OE e ka dorëzuar një faturë për blerjen e makinës mirëpo nuk disponon fare dëshmi të DUD-it doganor apo të pagesës së faturës.

Vlen të shtohet se makinat e tilla nuk prodhohen në Kosovë por duhet të importohen nga jashtë vendit.

Vlen të shtohet po ashtu se ky OE në deklaratën nën betim nuk ka evidentuar fare titullin e projektit dhe as numrin e prokurimit. Prandaj nuk dihet se për cilin projekt e ka dorëzuar deklaratën që nënkupton se AK nuk mund të kërkojë përgjegjësi në rast të ndonjë gabimi. Për këtë arsye kjo deklaratë është e pavlefshme.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “TSR” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 59 par. 4 të LPP. Nga sa u tha më sipër propozojmë që Paneli Shqyrtues të merr këtë: VENDIM MIRATOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “TSR” Sh.P.K. ashtu që ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në RIVLERËSIM.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim: Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 18.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Lipjanit" me nr. të Prokurimit 613-25-5988-2-1-1 përmes sistemit elektronik në E- prokurim.

Përgjigjja në pretendimin e parë :Bazuar në nenin 41 të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK.Shih shembullin e kalkulimit për tenderin me çmim jo normalisht të ulët me ofertat e përgjegjshme:Oferta 1 - 89.77 ;Oferta 2 =124.32 ;Oferta3 = 142.11 ; Oferta4 = 149.79 Shuma totale e 4 ofertave = 505.99Mesatarja e 4 ofertave është = 126.50 ; 126.50 - 30 % = 88.55 euro

Nga kjo shifet se kushti i parë nga udhëzuesi nuk është plotësuar për tu konsideruar si tender jo normalisht i ulët, sepse oferta me çmim më të lirë të përgjegjshëm është 89.77 euro Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 2 - OE "Sinjal" Sh.P.K. nuk e ka dorëzuar dëshmi dokumentare për makinën për shenjëzim me ngjyrë.

Përgjigja në pretendimin e dytë : OE “Sinjal” Sh.P.K. ka dorëzuar dokumentacionin përkatës i cili dëshmon posedimin e makinës për shenjëzim me ngjyre ne përputhje me kërkesat e AK ne FTD si dhe njoftim për kontrate. Pasiqe ne kërkesë te AK-se në FTD dhe njoftim për kontrate janë kërkuar disa pajisje me ngjyre, dhe pasiqe nuk e keni defnuar sakte se për cilën paisje behet fjale ju njoftojmë qe OE i propozuar për kontrate ka te gjitha dëshmitë për mjetet e punës sipas kërkesave te AK-se.Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 3 - OE "Traffiks VA" Sh.P.K. nuk ka dorëzuar dëshmi për makinën speciale për piketim me lëvizje motor. Përndryshe OE" Traffiks VA" Sh.P.K. as për pajisjet tjera nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme dokumentare sipas DT. Prandaj me rastin e rivlerësimit AK duhet të evidentoj këto të gjetura në vendimin e vet.

Përgjigja në pretendimin e tretë :OE Traffiks VA" shpk ka dorëzuar dëshmi te mjaftueshme për posedimin e pajisjeve te kërkuar përfshirë makine speciale për piketim ne lëvizje motorr. Dhe poashtu edhe për pajisjet tjera ka ofruar dëshmi te mjaftueshme sipas kërkesave te AK-së.Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 20,08.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 01.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0829/2025, ndërsa me datë 11.09.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0829/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “TSR” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0829 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Operatori ekonomik ka parashtuar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë procedurë të prokurimit. Pretendimet ankimore të ngritura me ankesë të cilat i takojnë karakterit teknik janë shqyrtuar nga eksperti teknik.

Pretendimi 1 ankimor çmimore, O.E. Sinjali SH.P.K. ka ofruar çmimin për pjesët dhe pozicionet si më poshtë;-pjesa nr. 1, pozicioni: 3, 4, 6 dhe 12 dhe pjesa nr.2, pozicioni: 3, 5, 6, dhe 12 O.E. Sinjali ka ofruar çmimin 0.10 cent. Ky çmim është shumë më i ulët se sa çmimet në treg.-ndërsa pjesa nr.1, pozicionet: 7, 9, 10, 11, 12 dhe 13, po ashtu pjesa nr.2, pozicionet: 9, 10 dhe 11, si dhe pjesa nr.3, pozicionet: 4, 5, 7 dhe 17 për këto O.E. Sinjali SH.P.K. ka ofruar 1 euro, gjë që është shumë i ulët krahasuar me çmimet në treg.-ndërsa, te pjesa nr.3, pozicioni: nr.2, 3, 10, 14 dhe 15 O.E. Sinjali SH.P.K. ka ofruar çmimin 5 euro, po ashtu edhe ky çmim nuk është sikur se çmimet në treg.

Për projektin në fjalë, eksperti teknik sqaron që çmimet e ofruara nga O.E. Sinjali Sh.P.K. nuk garantojnë cilësi të materialit, as të punës.

AK gjatë vlerësimit të ofertave është dashur të kërkoj sqarim shtesë nga O.E. Sinjali se çmimet e ofruara a përmbajnë cilësi të duhur të materialit dhe të punës, por një gjë të tillë AK nuk e ka kërkuar. Këtë pretendim ankimor të O.E. TSR SH.P.K. e konsideroj të bazuar.

Pretendimi 2 ankimor- Pika e parë, dokumentacioni (dëshmia) për makinën e gërryerjes, në DT është kërkuar DUD-I, apo fatura, por fatura është sjellur nga O.E. Sinjali. O.E. Sinjali makinën nuk e ka importuar, por e ka blerë në Kosovë dhe është në rregull sipas DT-së. Këtë pikë të këtij pretendimi ankimor si ekspert teknik e konsideroj të pabazuar.Sa i përket pretendimit për deklaratën nën betim ku thuhet se OE i rekomanduar nuk ka evidentuar fare titullin e projektit dhe as numrin e prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron që OE i rekomanduar ka dorëzuar deklaratën nën betim duke ju përmbajtur në tërësi formës standarde të vendosur në dosjen e tenderit nga ana e Autoritetit Kontraktues. Sipas pikës 44.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave duhet të dorëzojnë deklaratat sipas formularëve standard pa ndryshime në përmbajtje dhe pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga AK në format standarde. Pra, në rastin konkret OE i rekomanduar ka plotësuar formën standarde të bashkangjitur në DT dhe sipas mendimit të tij, eksperti konsideron që kjo deklaratë është në rregull. Andaj, në këtë pikë vlerësojmë që pretendimi është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e

Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613-25-5988-2-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TSR” SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TSR” SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit” me nr. të prokurimit: 613-25-5988-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - TSR SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: